

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Votimet - Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg! Një provë e re për Merzin pas humbjes së rëndë në Saksoni
ADRESA	https://www.syri.net/bote/917752/zgjedhjet-e-se-dieles-ne-berlin-dhe-mecklenburg-nje-prove-e-re-per-merzin-pas-humbjes-se-rende-ne-saksoni/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 07:33:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 06:32:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1f1a5cb7fb2f11fcb1508a3685a7eb19b25bebaedd41e11fb6c4b114e98a4397
TEKSTI	c60d4dbd8282cd5ac4c2e661d3f64b6a2dbca36a156c0dd5bd2641f5ddd92931
PAMJA	22b106db9e6be5ea240d887746503287ec1514ad94d3bda5dcc0abb00584ff02

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0c625e925a909bad0e6db367430b5f2149459c9f5351ff62c75fb13f0f0f6016
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2efc04bea43acf0f6a2e38be2863702e338fd789cd0cf3c1cc14a88f36ac9872
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0c625e925a909bad0e6db367430b5f2149459c9f5351ff62c75fb13f0f0f6016>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

**më të lexuarat**

Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar, qëllohet me 11 plumba

VIDEO/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të ikte

Pakistani dënon përpjekjen 'e neveritshme' për sulm me dron pranë Mekës

Ushtria izraelite nis sulme të reja në Libanin jugor pavarësisht marrëveshjes kornizë

Sulmet me dronë dhe raketa nga Irani/ SHBA thirrje amerikanëve: Rishqyrtoni udhëtimet në Arabinë Saudite

Filipine/ 6 nxënës të vrarë dhe 17 të tjerë të plagosur nga të shtënat në një shkollë të mesme



Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg! Një provë e re për Merzin pas humbjes së rëndë në Saksoni

08:32, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Të dielën, më 20 shtator, qytetarët në Berlin dhe në Mecklenburg-Pomeraninë Perëndimore do t'u drejtohen kutive të votimit për zgjedhjet e parlamenteve të tyre rajonale. Data e zgjedhjeve konfirmohet edhe nga Zyra Federale e Zgjedhjeve të Gjermanisë. Dy zgjedhjet zhvillohen në një klimë të rëndësishme për politikën gjermane, pasi AfD ka fituar peshë në landet lindore, ndërsa CDU e kancelarit Friedrich Merz përballet me rezultate të dobëta në disa sondazhe rajonale. Në Mecklenburg-Pomeraninë Perëndimore gara për vendin e parë mbetet shumë e ngushtë mes SPD-së së kryeministres Manuela Schwesig dhe AfD-së.

Sipas matjes më të fundit të Forschungsgruppe Wahlen, të publikuar më 17 shtator, SPD-ja merr 37%, ndërsa AfD-ja 36%. CDU-ja është në 6%, Die Linke në 9%, të Gjellbrit në 5% dhe BSW në 4%. Instituti thekson se këto janë vlera projektshme dhe jo parashikime të rezultatit përfundimtar. Një sondazh i mëparshëm i INSA-s e vendoste, ndërkohë, AfD-në në 37% dhe SPD-në në 35%, duke konfirmuar se diferenca mes dy partive mbetet brenda një intervali të ngushtë. Në zgjedhjet e vitit 2021, SPD fitoi 39.6% të votave, AfD 16.7%, ndërsa CDU 13.3%.

Edhe në Berlin gara mbetet e hapur. Sipas Forschungsgruppe Wahlen, Die Linke është në 22%, CDU në 20%, AfD në 18%, të Gjellbrit në 15% dhe SPD në 12%. BSW është në 4%. Një matje tjetër e Infratest dimap jep rezultate shumë të ngjashme: Die Linke 21%, CDU 20%, AfD 18%, të Gjellbrit 16% dhe SPD 12%. Çështja kryesore e fushatës në kryeqytet ka qenë kriza e strehimit dhe rritja e qirave. Sipas Reuters, qiratë në Berlin janë rritur ndjeshëm që nga viti 2014, ndërsa mungesa e banesave është kthyer në një nga temat kryesore të zgjedhjeve.

Çfarë do të thotë rezultati për Merz?

Rezultatet në dy landet do të ndiqen nga afër edhe në nivel federal. Friedrich Merz dhe CDU-ja përballen me presion politik pas forcimit të AfD-së në lindje të Gjermanisë dhe rezultateve të dobëta të CDU-së në disa prej sondazheve rajonale. Reuters e ka përshkruar zgjedhjen në Mecklenburg-Pomeraninë Perëndimore si një moment politik të rëndësishëm në historinë e Gjermanisë.

referendumet si një moment politikisht të veshtirë për kancelarin. Megjithatë, rezultati i këtyre zgjedhjeve nuk përcakton automatikisht të ardhmen e qeverisë federale. Ai mund të ndikojë në debatin brenda CDU-së dhe në marrëdhëniet politike në Berlin, por çdo ndryshim në nivel federal do të kërkonte procese të veçanta politike dhe institucionale.

Në Berlin, sondazhi i Forschungsgruppe Wahlen tregon gjithashtu se koalicioni aktual CDU-SPD nuk do të kishte shumicë sipas projeksionit të 17 shtatorit. Instituti vlerëson se disa kombinime të tjera do të mund të siguronin shumicë, por këto varen nga rezultati real dhe nga negociatat paszgjedhore.

Pra, fokusi i 20 shtatorit është i dyfishtë: në Mecklenburg-Pomerani do të shihet nëse SPD-ja mund të ruajë epërsinë ndaj AfD-së, ndërsa në Berlin vota mund të ndryshojë ekuilibrat e koalicionit në kryeqytet. Në të dyja rastet, rezultatet do të japin një tregues të rëndësishëm për gjendjen e politikës gjermane, pa qenë vetë një votë direkte për qeverinë federale të Merzit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të ikte



Vrasje brutale në Kolumbi! Autorja i zuri pritë para biznesit, biznesmeni 61-vjeçar, qëllohet me 11 plumba



E 'burgosi' bashkëshortin 19 orë në banjë pa ushqim e ujë, arrestohet 75-vjeçarja, pas vdekjes së burrit

Sanksionet e SHBA ndaj Rusisë/ Kina kundër: Marrëdhëniet dypalëshe s' duhet të prishen

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme gjatë natës, dëme në të dyja palët

BE i hap derën Kanadasë për t'u bërë 'anëtarja e parë e asociuar' e bllokut

TË NGJASHME



Arabia Saudite nën alarm pas një shpërthimi të fuqishëm gjatë natës




Kanadaja dhe BE: Një vështtrim në marrëdhënien e veçantë



I maskuar si grua dhe me fëmijë në krahë: Arrestohet vrasësi serial në Brazil. Ka rrëfyer 80 vrasje



Gjermania ul taksën e karburanteve dhe përgatit tavan çmimesh, paketa e ndihmës për qytetarë arrin 2.5 miliardë euro



Trump: Lufta me Iranin do të përfundojë së shpejti



Trump njofton marrëveshjen me Danimarkën për Groenlandën: SHBA do të rrisë pranimë ushtarake në ishull



Kapiteni egjiptian humb jetën pasi anija goditet pranë Rusisë, riatdhesohen 8 marinarë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.